



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha (udhëheqës ekipi), Fatlinda Podvorica dhe Shqiponja Krasniqi (anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Zukë Zuka.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	18
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	23
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	25

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore janë përgatitur në harmoni me kërkesat ligjore. Menaxhimi financiar dhe kontrolli - vazhdon të mbetet mjaft sfidues për menaxhmentin e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN). Veprime shtesë për përmirësime nevojiten sidomos në fushën e Subvencioneve, pagesën e obligimeve dhe menaxhimin e pasurisë.

Zbatimi i rekomandimeve – Edhe pse MIN kishte zbatuar 7 nga 14 rekomandimet e vitit 2018, ende mbetet numër i madh i rekomandimeve të pazbatuara.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i Pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të MIN për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht, shih kapitullin 1 të këtij raporti.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të MIN për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i Pa modifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik të kontabilitetit në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MIN është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet

mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Falënderojmë menaxhmentin dhe stafin e ministrisë për bashkëpunimin korrekt dhe ndihmën e ofruar gjatë procesit të auditimit.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë eventuale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit tek investimet kapitale, menaxhimi i subvencioneve/granteve, klasifikimi i shpenzimeve në kode dhe kategori ekonomike adekuatë si dhe menaxhimi i pasurisë.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	11,167,520	5,090,088	2,351,312	46%	5,116,773	5,038
Granti i Qeverisë - Buxheti	9,167,520	3,487,748	2,022,890	58%	5,116,773	5,038
Te hyrat nga AKP	2,000,000	1,602,340	328,422	20%	0	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 6,077,432€. Ky është rezultat i shkurtimeve buxhetore me vendime të Qeverisë. Në vitin 2019, MIN ka shpenzuar vetëm 46% të buxhetit final.

Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale të shpenzimeve sipas kategorive.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,167,520	5,090,088	2,351,312	46%	5,116,773	5,038
Pagat dhe Mëditjet	369,520	311,578	311,578	100%	208,863	0
Mallrat dhe Shërbimet	425,000	413,300	382,256	92%	260,443	5,038
Shërbimet komunale	23,000	5000	4,063	81%	1,544	0
Subvencionet dhe Transferet	6,350,000	1,896,700	930,656	49%	4,424,330	0
Investimet Kapitale	4,000,000	2,463,510	722,759	29%	221,593	0

Në vijim janë paraqitur zvogëlimet e buxhetit nëpër kategori si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore:

- Buxheti për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 57,942€;
- Buxheti për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitë) në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 29,700€;
- Buxheti për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 4,453,300€. MIN kishte anuluar thirrjen publike për financimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në fushën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë; dhe
- Buxheti për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 1,536,490€, pasi për disa projekte kapitale nuk ishin inicuar fare procedurat e prokurimit.

MIN, kishte treguar performancë jo të mirë sa i përket realizimit të buxhetit final (49%), kjo ishte ndikuar kryesisht nga realizimi i ulët i buxhetit tek investimet kapitale prej vetëm 29% e buxhetit final. Shkaku i realizimit të ulët i buxhetit tek investimet kapitale ishte kryesisht mos iniciimi i procedurave të prokurimit nga njësitë kërkuese si dhe ndryshimeve në menaxhmentin e lartë.

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2019 ishte 311,578€, i cili ishte realizuar në tërësi. Numri i punëtorëve të planifikuar me Ligj të buxhetit ishte 52, ndërsa numri aktual i punëtorëve në MIN në fund të vitit 2019 ishte 44.

Ne kemi testuar 19 mostra për teste substanciale në vlerë 12,413€, si dhe tetë (8) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitetë) në vitin 2019 ishte 418,300€, ndërsa ishin shpenzuar 386,319€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, shpenzime të reprezentacionit, qiraja për automjete, shërbime kontraktuese, blerja e pajisjeve të TI-së, inventarit etj.

Prej 24 mostrave të përzgjedhura për teste substanciale në vlerë 59,158.72€, dhe shtatë (7) mostra për teste të pajtueshmërisë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja A1- Shpenzimet shtesë për pagesat me vendime gjyqësore

Gjetja Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 39.1 ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Nga testimi i dy pagesave në vlerë totale prej 15,947€ të cilat ishin realizuar në bazë të vendimeve gjyqësore, kemi vërejtur se MIN kishte paguar 2,595€ si shpenzime shtesë për procedurë gjyqësore, përmbartimore dhe interes.

Shkaku i këtyre pagesave ishin kryesisht vonesat në shlyerjen e obligimeve. Sipas zyrtarëve përgjegjës, me datë 24-26 janar 2018, MIN kishte organizuar një konferencë, mirëpo nuk kishte ndonjë marrëveshje të shkruar, prandaj ka qenë e pamundur të realizohet pagesa.

Ndikimi Realizimi i pagesave të bazuara në vendime gjyqësore ndikojnë në dëmtimin e buxhetit për shkak të pagesës së shpenzimeve përmbartimore, interesit, taksat, etj.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë e detajuar për shkaqet e ekzekutimit të pagesave me vendime gjyqësore dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim eliminimin e pagesave shtesë për vendime gjyqësore.

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,896,700€. Prej tyre në vitin 2019 ishin shpenzuar 930,656€. Ato kanë të bëjnë me mbështetjen financiare ndaj OJQ-ve për promovimin e zhvillimit të inovacionit dhe ndërmarrësisë, si dhe financimin e bizneseve fillestare "Startup" në fushën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Në këtë fushë kemi testuar 55 mostra për teste substanciale në vlerë 168,359€, dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Auditimi ynë ka identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja A2 - Mos hapja e bizneseve Start-up

- E gjetura** Ministria e Inovacionit dhe Nërmarrësisë gjatë vitit 2019 kishte realizuar pagesa për financimin e Bizneseve Start-up në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë.
- Në bazë të nenit 8 të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet MIN dhe përfituesve të granteve Startup, hapja e bizneseve si shoqëri tregtare duhet të bëhet brenda gjashtë muajve nga nënshkrimi i kontratës. Kontratat ndërmjet MIN dhe përfituesve ishin nënshkruar me datë 04.09.2019 dhe ishin realizuar pagesat në llogari private të përfituesve. Sipas kontrates periudha e hapjes së bizneseve ishte gjashtë (6) muaj (deri në mars 2020). Nga 48 mostrat e testuara, në 10 raste përfituesit e granteve Start-up nuk kishin hapur fare bizneset. Kjo situatë është vlerësuar në kohën e procesit të auditimit në korrik të vitit 2020. Sipas ministrisë, shkaqet e ngecjes së këtij projekti ishin si pasojë e riformatimit të Qeverisë dhe mos përcaktimit të qartë të vendimmarrjes në këtë proces. Kjo çështje mbetet të përcillet edhe në auditimin në vijim.
- Ndikimi** Mos hapja e bizneseve Start-up, ndikon në mos përmbushjen e objektivave të ministrisë, njëkohësisht kjo ka ndikim në shpenzimin e mjeteve të pa arsyeshme dhe të pa arsyetuara.
- Rekomandimi A2** Ministri duhet të siguroj monitorim adekuat të projektit Start-up, me qëllim të vlerësimit të objektivave të ministrisë. Kjo situatë kërkon një vlerësim rigoroz në këtë vit, të përcaktohen qartë përgjegjësitë në vendimmarrje, në mënyrë që të përmbillet procesi i krijimit të bizneseve nga përfituesit, apo në të kundërtën të kthimit të mjeteve.

Çështja B1- Mos raportimi nga përfituesit e subvencioneve dhe transfereve

Gjetja Bazuar në marrëveshjet e lidhura mes MIN dhe përfituesve të subvencioneve Startup, përfituesit duhet të ofrojnë çdo tremujor një raport narrativ dhe financiar dhe Raportin Përfundimtar narrativ dhe financiar mbi zbatimin e aktiviteteve.

Nga katër raste të testuara për përfituesit e mbështetjes nga Startup, kemi vërejtur se tre prej tyre nuk i kishin sjellur të gjitha dëshmitë/faturat lidhur me shpenzimin e mjeteve apo në përputhje me aktivitetet e planifikuara në propozim buxhetet, ndërsa në një rast përfituesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi/fatura lidhur me shpenzimin e mjeteve.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos përgjegjshmërisë nga përfituesit edhe pse Komisioni Monitorues u ka dërguar vërejtje me shrim për mos dorëzimin e raporteve dhe faturave si dhe janë paralajmëruar bazuar në Marrëveshjen e nënshkuar mes MIN dhe përfituesve për masat e mëtutjeshme në rast të mos raportimit. Mirëpo, nuk janë ndërmarrë masa ndëshkuese apo masa tjera.

Ndikimi Mos raportimi i mjeteve të shpenzuara, mungesa e faturave dhe sigurimi i faturave që nuk dëshmojnë se mjetet janë shpenzuar në përputhje me qëllimin e dhënë, mund të rezultojë me devijime nga qëllimet e përfitimit të mjeteve dhe humbjen e vlerës për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi B1 Ministri, të siguroj ndërmarrjen e masave shtesë ndaj monitorimit të përfituesve nga OJQ-të dhe Startup-et, për sigurimin e dëshmimeve të vlefshme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve, në përputhje me qëllimin e dhënë. Nëse këto nuk arsyetohen brenda periudhës së definuar në kontratë, të merren masa ndëshkuese ndaj këtyre përfituesve.

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2019 ishte 2,463,510€, ndërsa ishin shpenzuar 722,759€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin dhe pajisje të Qendrave Rajonale të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Furnizim me pajisje të TI për shkollat e mesme, Furnizim me pajisje laboratorike për zhvillim të koncepteve inovative për Universitete, etj.

Prej 12 mostrave të përzgjedhura për teste substanciale në vlerë 722,758€, dhe një (1) mostër për teste të pajtueshmërisë. Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.1.5 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, investimet kapitale si dhe subvencionet dhe tranferet

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat si dhe shërbimet, investimet kapitale:

Çështja A3 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare 01/2013-Shpenzimi i parave publike, neni 18-Inicimi i Shpenzimeve, pika 3. Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël.

Nga 24 mostrat e testura në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në katër raste shpenzimet ishin regjistruar në kode ekonomike jo adekuate brenda kategorisë.

- Pagesa furnizim me inventar vlera 7,212€, është regjistruar në kodin 13610 Furnizime për zyrë;
- Dy pagesa për qira të ndërtesës vlera 8,800€, janë regjistruar në kodin 14150 Qiraja për përdorime tjera hapësinore, ndërsa është dashur të regjistrohen në kodin 14110 Qeraja për ndërtesa; dhe
- Pagesa për mbajtjen e konferencës vlera 9,202€, (shpenzimet për akomodim, dreka zyrtare) është regjistruar në kodin 13620 Furnizime me ushqim dhe pije.

Po ashtu nga 12 mostrat e testura në kategorinë ekonomike investime kapitale, në katër raste shpenzimet ishin regjistruar në kode ekonomike jo adekuate brenda kategorisë.

- Pagesa furnizim me pajisje Laboratorike për projektin qendra e inovacionit dhe ndërmarrësisë, vlera 249,546€, është regjistruar në kodin 31120 Ndërtesat Administrative Afariste, ndërsa është dashur të bëhet nga kodi 31690 Pajisje Tjera;

- Pagesa furnizim me pajisje për Qendrën e Inovacionit të Ndërmarrësisë në UMIB – Mitrovicë, vlera 8,800€, është bërë në kodin 31120 Ndërtesat Administrative Afariste, duhet të bëhet nga kodi 31690 Paisje Tjera; dhe
- Pagesa për Furnizim me inventar (tavolina dhe karriga) për Laboratorët Kompjuterike në UMIB- Mitrovicë, në vlerë 18,000€, është bërë në kodin 31120 Ndërtesat Administrative Afariste tek kategoria Investimet Kapitale, ndërsa furnizimi është pasuri jo financiare me vlerë nën 1000€ dhe duhet të regjistrohet tek kategoria Mallra & Shërbime në kodin ekonomik 13501.

Ndikimi Regjistrimi i shpenzime në kode ekonomike jo adekuate rezulton me paraqitje dhe shpalesje jo të drejtë të shpenzimeve në PVF bazuar në natyrën reale të shpenzimit.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurojë se regjistrimi i shpenzimeve bëhet në kode dhe kategori ekonomike adekuate, siç parashihet me planin kontabël të SIMFK me qëllim të prezantimit dhe shpalesjes së informatave të drejta për shfrytëzuesin e raporteve financiare.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Në PFV-të e Ministrisë, pasuritë kapitale nuk ishin shpalosur fare, ndërsa ato jokapitale ishin shpalosur në vlerë 37,453€, dhe stoqet ishin 6,452€.

Auditimi ynë ka identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja B2- Dobësitë në regjistrimin e pasurive

Gjetja

Sipas rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizata buxhetore, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK. Po ashtu, stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.

Pagesat e realizuara nga investimet kapitale në vlerë prej 944,351€ (vlera 722,758€ e realizuar gjatë vitit 2019 dhe 221,592€ të realizuara gjatë vitit 2018) MIN nuk i kishte regjistruar si pasuri, përkatësisht si investime në vijim në SIMFK, si dhe nuk ishin të shpalosura në PFV. Me datën 15.01.2020 kishin bërë kërkesë në komunat përkatëse për transferim dhe regjistrim të pasurisë në SIMFK për projektet e përfunduara për vitin 2019:

- Ndërtimi i kabinetit të informatikës në shkollën “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Drenas;
- “Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Ferizaj”;
- Ndërtimi i kabinetit të informatikës në shkollën “Asim Vokshi” në Panorc të Komunës së Malishevës;
- Rregullimi i Objektivit Multifunksional Inovativ në Shtime;
- “Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Universitetin e Mitrovicës”; dhe
- “Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Universitetin e Prishtinës”.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së certifikimit të zyrtarit të pasurisë për përdorim të sistemit SIMFK, i cili ishte certifikuar nga MF me datën 16/01/2020.

Në anën tjetër, MIN nuk ka regjistër të stoqeve. Në PFV stoqet janë paraqit në vlerë 6,453€, ku sipas regjistrimit të ofruar nga zyrtari i pasurisë kjo vlerë është e pasurisë jo kapitale e cila gjindet në depo. Kjo kishte ndodh pasi ministria nuk kishte marrë qasje në përdorimin e sistemit e-pasurisa deri në gjysmën e dytë të vitit 2019, si dhe faturat e materialit shpenzues kanë qenë para datës së fillimit të implementimit të sistemit e-pasuria.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive kapitale, përkatësisht investimeve në vijim, në regjistrin kontabël dhe stoqeve, rezulton me mungesë të informatave të sakta rreth pasurisë së ministrisë, duke pamundësuar menaxhimin dhe kontrollin efektiv mbi to.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektet kapitale të regjistrohen në SIMFK si investime në vijim deri në përfundim të projektit dhe me rastin e pranimit përfundimtar të projektit, këto investime në vijim të barten në regjistrat e komunës, të cilës i takon pronësia. Po ashtu, të siguroj se stoqet janë regjistruar në sistemin e-pasuria ashtu siç kërkohet me Rregullore.

Çështja B3 - Mos inventarizimi i pasurisë së MIN

Gjetja Sipas Rregullores nr. 02/2013 – Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, neni 18, kërkon që organizatat buxhetore të inventarizojnë së paku një herë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të saj. Raporti i inventarizimit duhet të bëhet para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

MIN nuk kishte bërë Inventarizimin e pasurisë në fund të vitit 2019 para përgatitjes së PVF. Edhe pse MIN kishte formuar një komision për inventarizimin e pasurisë me 24.04.2019. Komisioni kishte përfunduar raportin me 29.05.2019, mirëpo jo siç e kërkon rregullorja në fund të vitit para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mos kryerja e procesit të inventarizimit, nuk ofron sigurinë për ekzistencën fizike të pasurive të blera dhe pamundëson paraqitjen e saktë të informatave lidhur me pasuritë në PFV dhe shpalosjen e tyre në mënyrë të drejtë. Kjo gjithashtu ka efekt në menaxhimin dhe kontrollin e duhur ndaj pasurive të ministrisë.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të siguroj caktimin e komisionit për inventarizim të pasurive ashtu siç parashihet me rregullën financiare për pasurinë jo financiare të organizatave buxhetore. Procesi i inventarizimit duhet të përfundoj para se PFV të jenë dorëzuar, në mënyrë që rezultatet e inventarizimit të reflektohen në raportimet vjetore.

2.3 Detyrimet

2.3.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në PVF në fund të vitit 2019, ishte 14,488€. Arsye e mos shlyerjes së këtyre obligimeve ishte kryesisht: pranimi i disa faturave me vonesë pas mbylljes së sistemit. Këto obligime janë bartur për tu realizuar në vitin 2020.

Çështja A4-Vonesa në realizimin e pagesave të detyrimeve

- Gjetja** Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 39, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagim.
- MIN në katër raste, faturat/detyrimet ndaj furnitorëve në vlerë totale 259,834€ i kishte paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh. Vonesat sillen nga 2- 134 ditë.
- Kjo ka ndodhur pasi që MIN nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për procedimin e pagesave.
- Ndikimi** Vonesat në pagesa, rrisin rrezikun e hyrjes në obligime pa mbulesë buxhetore apo përballje me konteste gjyqësore, duke krijuar edhe shpenzime shtesë dhe vështirësi buxhetore për vitet pasuese.
- Rekomandimi A4** Ministri duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës siç parashihet me neni 39 të Ligjit për menaxhimin e financave publike.

2.3.2 Detyrimet e kontraktuara

Vlera e detyrimeve të kontraktuara sipas raporteve të MIN është 18,688€.

Detyrimet e kontraktuara kanë të bëjnë me kontratat për mallra dhe shërbime të cilat janë mbi një vit dhe të cilat ende nuk kanë përfunduar.

2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Ne marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e komitetit të auditimit. Subjektet e sektorit publik duhet të themelojnë NJAB të pavarur nëse plotësojnë kriteret e përcaktuar me Rregulloren 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik ose të sigurojnë shërbime nga njësi tjera të AB-së.

MIN nuk kishte themeluar NJAB gjatë vitit 2019, megjithatë për shkak të fuzionimit të MIN me një Ministri tjetër, nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 kishte rezultuar në 14 rekomandime. Për këto, MIN kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitej mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2019, shtatë (7) ishin zbatuar, një (1) ishte në proces të zbatimit, tre (3) rekomandime ishin të pazbatuara, dhe tre (3) konsiderohen të mbyllura të pazbatuara.

MIN nuk ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën e rekomandimeve numër 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PVF	<p>Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektin e Qendrës Rajonale të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Ferizaj, janë regjistruar në SIMFK si investime në vijim deri në përfundim të projektit dhe me rastin e pranimit përfundimtar të projektit, këto investime në vijim barten në regjistrat e komunës, të cilës i takon pronësia.</p> <p>Ministri, duhet të siguroj se janë marrë veprime të menjëhershme për sigurimin e qasjes në e-pasuri dhe caktimin e zyrtarit përgjegjës për pasuri, në mënyrë që të gjitha pasuritë jokapitale të ministrisë regjistrohen dhe mirëmbahen në mënyrë të rregullt dhe si të tilla të prezantohen drejtë në PFV.</p>	Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi.	I pazbatuar
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të rishikoj shkaqet e mos realizimit të buxhetit dhe të ndërmerr veprime përmirësuese në fushat ku projektet nuk kanë arritur të realizohen. Performanca buxhetore duhet të jetë subjekt i rishikimit dhe monitorimit të rregullt nga menaxhmenti.	Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi.	I Mbyllur i pazbatuar

3	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për plotësimin e pozitave të lira me staf të rregullt dhe jo përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, ndërsa këto të fundit të aplikohen vetëm për punë/shërbime të veçantë.	MIN ka adresuar këtë rekomandim duke shpallur konkurse për pozita të rregullta dhe nuk kishte pranuar staf me MSH gjatë vitit 2019.	I zbatuar
4	Mallra dhe shërbimet	Ministri, të siguroj se janë vendosur kontrole efektive tek menaxhimi i avanceve për udhëtime zyrtare, në mënyrë që zyrtarët të jenë përgjegjës për arsyetimin e mjeteve me kohë dhe kthimi i mjeteve të pashpenzuara në llogari të bëhet brenda afatit ligjor.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2019.	I zbatuar
5	Mallra dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj se shfrytëzimi i avancit për udhëtime zyrtare për blerje të pa autorizuar, nuk do të përsëritet në asnjë rast tjetër.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2019.	I zbatuar
6	Mallra dhe shërbimet	Ministri duhet të rishikoj rastin e këtyre pagesave dhe të konfirmoj nëse pagesat janë kryer për punët e kryera jashtë orarit të rregullt të punës. Në të kundërtën, paratë t'i kthehen buxhetit të ministrisë.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2019.	I zbatuar
7	Subvencionet dhe tranferet	Ministri duhet të rritë masat e përgjegjësisë ndaj komisionit të vlerësimit të OJQ-ve, për të siguruar se vlerësimi i aplikacioneve bëhet me përgjegjësi dhe objektivizëm sipas kritereve të përcaktuara dhe kërkesave tjera ligjore.	Nuk kemi hasur raste të tilla në vitit 2019.	I zbatuar
8	Subvencionet dhe tranferet	Ministri, si edhe në rekomandimin më lart, duhet të vendos kontrole rigorozë në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për financim të bizneseve Start-Up, në mënyrë që përzgjedhja e përfituesve bëhet bazuar në objektivat e thirrjes për financim, në përputhje me udhëzimin administrativ përkatës të ministrisë.	Nuk kemi hasur raste të tilla në vitit 2019.	I zbatuar

9	Subvencionet dhe tranferet	Ministri, duhet të merr masa të menjëhershme dhe të ndërpres praktikat e tilla, duke vendosur mekanizma efektiv të mbikëqyrjes ndaj procesit të vlerësimit për mbështetje financiare ndaj Start Up-ve dhe të siguroj se komisionet e vlerësimit kryejnë punën me përgjegjësi të lartë. Në rastet ku financimi ka qenë shpenzim i papranueshëm, sikurse blerja e automjetit komercial, mjetet e përfituara të kthehen në buxhetin e ministrisë.	Sa i përket vlerësimit janë vendosur mekanizma, ndërsa mbikëqyrja mbetet sfiduese për MIN.	Pjesërisht i zbatuar
10	Subvencionet dhe tranferet	Ministri, të siguroj ndërmarrjen e masave shtesë ndaj monitorimit të përfituesve nga OJQ-të dhe Start Up-et, për sigurimin e dëshmive të vlefshme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve, në përputhje me qëllimin e dhënë. Nëse këto nuk arsyetohen brenda periudhës së definuar në kontratë, të merren masa ndëshkuese ndaj këtyre përfituesve.	Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi.	I pazbatuar
11	Investimet Kapitale	Ministri, të ndërmerr masa për caktimin e zyrtarit mbikëqyrës të projektit “Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë”, i cili në bashkëpunim me komunën të siguroj se projekti realizohet në afat sa më të shpejtë në mënyrë që kjo qendër fillon funksionimin e saj. Po ashtu, të siguroj se pozicionet të cilat janë paguar dhe nuk janë përfunduar, të finalizohen në pajtim me kontratën, në të kundërtën, për punët e pa përfunduara të kërkoj kthimin e mjeteve në buxhetin e ministrisë.	Ministria ka caktuar zyrtarin mbikëqyrës të këtij projekti.	I zbatuar
12	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ministri duhet të siguroj caktimin e komisionit për inventarizim të pasurive ashtu siç parashihet me rregullën financiare për pasurinë jo financiare në OB. Procesi i inventarizimit duhet të përfundoj para se PFV 2019 të jenë dorëzuar, në mënyrë që rezultatet e inventarizimit të reflektohen në pasqyra.	Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi.	I pazbatuar

13	Funksioni i Auditimit të Brendshëm	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa, në mënyrë që shërbimet e auditimit të brendshëm të sigurohen përmes themelimit të NjAB brenda ministrisë apo nga ndonjë organizatë tjetër buxhetore.	Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi, megjithatë për shkak të fuzionimit të kësaj ministrie me një ministri tjetër konsiderohet i mbyllur.	I mbyllur i pazbatuar
14	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhim i rrezikut	Ministri, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, dhe ecuritë buxhetore, përfshirë edhe shpenzimet dhe plani i prokurimit, të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga menaxhmenti. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, ministria duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi, megjithatë për shkak të ndryshimit të formatit të raportit të auditimit nuk do të përsëritet.	I mbyllur i pazbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë e detajuar për shkaqet e ekzekutimit të pagesave me vendime gjyqësore dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim eliminimin e pagesave shtesë për vendime gjyqësore.		
2	Subvencionet dhe tranferet	Ministri duhet të siguroj monitorim adekuat të projektit Start-up, me qëllim të vlerësimit të objektivave të ministrisë. Kjo situatë kërkon një vlerësim rigoroz në këtë vit, të përcaktohen qartë përgjegjësitë në vendimmarrje, në mënyrë që të përmbillet procesi i krijimit të bizneseve nga përfituesit, apo në të kundërtën të kthimit të mjeteve.		
3	Subvencionet dhe tranferet	Ministri, të siguroj ndërmarrjen e masave shtesë ndaj monitorimit të përfituesve nga OJQ-të dhe Start Up-et, për sigurimin e dëshmive të vlefshme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve, në përputhje me qëllimin e dhënë. Nëse këto nuk arsyetohen brenda periudhës së definuar në kontratë, të merren masa ndëshkuese ndaj këtyre përfituesve.		

4	Çështjet e përbashkëta mallra dhe shërbime	Ministri duhet të sigurojë se regjistrimi i shpenzimeve bëhet në kode dhe kategori ekonomike adekuate siç parashihet me planin kontabël të SIMFK-së me qëllim të prezantimit dhe shpalosjes së informatave të drejta për shfrytëzuesin e raporteve financiare.
5	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektet kapitale të regjistrohesh në SIMFK si investime në vijim deri në përfundim të projektit dhe me rastin e pranimit përfundimtar të projektit, këto investime në vijim të barten në regjistrat e komunës, të cilës i takon pronësia. Po ashtu, të siguroj se stoqet janë regjistruar në sistemin e-pasuria ashtu siç kërkohet me Rregullore.
6	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ministri duhet të siguroj caktimin e komisionit për inventarizim të pasurive ashtu siç parashihet me rregullën financiare për pasurinë jo financiare të organizatave buxhetore. Procesi i inventarizimit duhet të përfundoj para se PFV të jenë dorëzuar, në mënyrë që rezultatet e inventarizimit të reflektohen në raportimet vjetore.
7	Detyrimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës siç parashihet me neni 39 të Ligjit për menaxhimin e financave publike.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Mentor Sylmeta, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

Përfaqëson: Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

Data: 28/07/2020 Prishtinë

